



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Biznesi ndërkombëtar EKB0019

Bartësi i lëndës:	Fisnik Reçica
Email:	fisnik.recica@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322
Mësimdhënësit e Lëndës:	Dorina Kralani

Hyrje

Lënda Biznesi Ndërkombëtar është obligative për studentët e vitit të tretë, semestri V. Lënda do të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme rreth teorive dhe praktikave të biznesit ndërkombëtar. Lënda do të trajtojë konceptet, modelet, strategjitë dhe problemet që bizneset hasin në tregjet ndërkombëtare.

Qëllimet

Lënda ka për qëllim që t'i pajisë studentët me njohuritë rreth teorive, modeleve, implikimeve dhe sfidave që përcillen gjatë angazhimit në biznes në kontekst ndërkombëtar. Pas kompletimit me sukses të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të analizojnë dhe konsiderojnë të gjithë faktorët relevant që mund të ndikojnë biznesin ndërkombëtar, ecuritë në eksport-import të mallrave dhe shërbimeve, të kapitalit, në njohjen e kulturës së vendit në të cilin bëhet biznes, funksionimin e institucioneve financiare ndërkombëtare, etj.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Studenti arrinë të kuptojë dhe sqarojë bazat e teorisë mbi biznesin ndërkombëtar, historinë e zhvillimit të biznesit ndërkombëtar, rolin e institucioneve financiare ndërkombëtare, kontekstin juridik, politik dhe kulturor, si dhe modalitetet e ndryshme të përfshirjes në biznes ndërkombëtar.
- Studenti arrinë të dallojë përparësitë dhe mangësitë ekonomike të këmbimit tregtar në mes të vendeve.
- Studenti arrinë të kuptojë dhe sqarojë kornizën globale monetare, tregun e këmbimeve valutore, llojet e mundshme të përfshirjes në biznes ndërkombëtar si dhe menaxhimin e operacioneve ndërkombëtare.
- Studenti arrinë të përshkruajë ndikimin e biznesit global në ndërmarrjet dhe ekonominë nacionale.

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Njohja me lëndën dhe diskutim i syllabusit; Domosdoshmëria e biznesit ndërkombëtar	Përshkrimi i lëndës dhe ligjërata e parë
2	Mjedisi Kulturor Nderkombetar	Ligjërata dhe ushtrime

3	Teorite e Tregtise dhe Investimeve	Ligjërata dhe ushtrime
4	Politika dhe Ligjet ne Biznesin Nderkombetar	Ligjërata dhe ushtrime
5	Integrimi ekonomik midis vendeve	Ligjërata dhe ushtrime
6	Sistemi monetar ndërkombëtar dhe ushtrime per Testin 1	Ligjërata dhe ushtrime
7	Testi 1	Testi 1 do të përfshijë materialin e mbuluar deri në javën 6
8	Tregjet në tranzicion dhe ushtrime për prezantim	Ligjërata dhe ushtrime
9	Drejtimi ndërkombëtar i burimeve njerëzore	Ligjërata dhe ushtrime
10	Operacionet fillestare të biznesit ndërkombëtar	Ligjërata dhe ushtrime
11	Operacionet e avancuara të biznesit ndërkombëtar	Ligjërata dhe ushtrime
12	Tregtia me kompensim	Ligjërata dhe ushtrime
13	Drejtimi financiar ndërkombëtar	Ligjërata dhe ushtrime
14	Testi 2 / Prezantime	Testi 2 do të përfshijë materialin e mbuluar pas javës 7, dhe studentët do të prezantojnë punimet e tyre
15		

Informata shitesë 1:

Pjesa teorike do të ndihmojë studentët që të kuptojnë konceptet kryesore dhe të fitojnë njohuritë e nevojshme mbi modelet, operacionet dhe implikimet që mund të ketë të bërit biznes në kontekst ndërkombëtar. Gjatë orëve të praktikës, studentët do të analizojnë raste studimore të bizneseve të ndryshme në botë, për të kuptuar operacionet, sfidat dhe mënyrën se si mund të adresohen nevojat e të bërit biznes në mes ndërmarrjeve në shtete të ndryshme. Pjesa teorike dhe praktike do t'u mundësojë studentëve që, pas përfundimit të suksesshëm të studimeve, të posedojnë njohuri teorike dhe aplikative, të nevojshme për punësim në funksione që ndërlidhen me operacione të biznesit ndërkombëtar.

Informata shitesë 2:

Prezantimet në PowerPoint do të përdoren gjatë ligjëratave. Gjatë ligjëratave studentët do të inkurajohen që të jenë pjesëmarrës aktiv në diskutim. Në orët praktike do të analizohen raste studimore, në grup dhe individualisht, për të kuptuar operacionet, sfidat dhe mënyrat e veprimit të bizneseve të përfshira në tregti ndërkombëtare, si dhe forma të tjera të të bërit biznes mes bizneseve të vendeve të ndryshme. Studentët do të përgatisin seminare dhe prezantime mbi analizën e teorive, politikave dhe praktikave të biznesit ndërkombëtar.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Test	35	Po	Do të mbahet në javën e 7 dhe do të përfshijë materialin e mbuluar nga java 1-6.
2	Prezentim	20	Po	Studentët do të prezantojnë punimet, në grup nga më së shumti 3 student.
3	Test	35	Po	Testi i dytë do të mbulojë materialin i cili nuk është mbuluar në testin 1 - javët 7 deri 13.
4	Pjesëmarrja	10	Po	Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë është i obligueshëm. Poenët nga pjesëmarrja do të jenë të barabartë me përqindjen e pjesëmarrjes në ligjërata dhe ushtrime.

Kushtet e përsëritjes:

Sipas rregullores së studentëve të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit deri në 3 herë. Nëse edhe në herën e tretë studenti nuk arrinë që të kalojë lëndën me sukses, atëherë vlerësimet e mëhershme (vijueshmëria, vlerësimet e kollokviumeve), gjatë ligjëratave, ruhen deri në afatin e fundit të rregullt për të kaluar lëndën. - Nëse studenti nuk arrinë që të kalojë lëndën as në herën e tretë, ai/ajo duhet të përsërisë lëndën edhe një herë.

Burimet:

- 1. Kristo, I., Biznesi Ndërkombëtar. SHBLU. 2004. 2. Czinkota, R. M.
- Ronkainen, A. I. dhe Moffet H. M. Biznesi Ndërkombëtar, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare. Libë i përkthyer 2010. 3. Materiale të tjera shtesë, të nevojshme për njësitë mësimore.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	
Ushtrime:	1	
L+U:	3	
Seminar/praktike.:	0	
Studim i vazhdushem:	60	
Pregaditja e Provimit:	40	
Pjesemarrja ne teste:	2	
Pjesemarrja ne provimin final:	3	
Me profesorin dhe asistentin:	15	
Total Ore:	165	
ECTS:	6	